

Marreveshje Transferimi
te Pjeseve te Kapitalit te shoqerise "R & V Management" Sh.p.k.

Ne Tirane, sot me 30/12 /2021, palet e kesaj Marreveshjeje rane dakort si me poshte:

Shitesi:

- **Z. Renato Yzo**, shtetas shqiptar, lindur më 10/10/1987, në Vreshtas, Korçë, banues në: Rruga "Ali Shefqeti", Tiranë, mbajtës i dokumentit Pasaportë me nr. BF0399902, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

(me poshte referuar "SHITESI")

dhe

Bleresi:

- **Z. Erjon Curraj**, shtetas shqiptar, lindur me 20/01/1981, ne Vlore, banues ne Tirane, Rruga Sali Butka 76, Pallati Sinani, Kati 6, Ap 12, mbajtes i dokumentit Karte Identiteti me nr. 036292808 dhe Nr. Personal I10120107N, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

(me poshte referuar "BLERESI")

MEQENESE:

- A. Shitesi zoteron 100% te Kapitalit te Shoqerise "R & V Management" Sh.p.k., nje shoqeri ekzistuese sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT M01511026I, me seli ne: Rruga "Shefqet Musaraj", Pallati Sinani, pas UET, Kati 0, Tirane, ("Shoqeria"), me nje kapital prej 3.000.000,00 leke, i perbere nga 1 kuote.
- B. Bleresi deshiron te bleje 30 % Kapitalit te Shoqerise te zoteruar nga Shitesi ne shoqerine e lartpermendur "R & V Management" Sh.p.k. siç percaktohet ne kete marreveshje.
- C. Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe nenet e Statutit te Shoqerise, Asambleja e Ortakeve te shoqerise ka marre vendimin perkates per transferimin tek Bleresi te kuotave si me siper.

PER SA ME SIPER, palet bien dakort si me poshte:

1. Shitesi pranon se ka marre nga Bleresi ne menyre te plote te gjithe çmimin e blerjes te rene dakord ne vleren prej 900.000 leke (nenteqind mije leke) dhe per kete arsye transferon ketu 30% te Kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne Kapitalin e Shoqerise "R & V Management" Sh.p.k., ne pronesi te Bleresit.
Shitesi deklaron dhe garanton Bleresin se 30% e kapitalit qe transferohet ketu eshte ne pronesine e tij te plote ligjore dhe te lira nga barra, hipoteke apo pengje.
2. Bleresi pranon pronesine e 30% te kuotave te kapitalit te shoqerise, duke njohur gjendjen e Shoqerise dhe bien dakord me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e lindura nga

zoterimi i Kuotave brenda Shoqerise, sipas percaktimeve te Statutit te Shoqerise dhe ligjit shqiptar.

3. Me nenshkrimin e kesaj Marreveshje, ortakete shoqerise dhe pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne shoqerine "R & V Management" Sh.p.k. do te jene:
 - **Z. Renato Yzo**, - zoteron 70% te kapitalit te shoqerise
 - **Z. Erjon Curraj**, - zoteron 30% te kapitalit te shoqerise
4. Shitesi dhe Bleresi bien dakord te zbatojne dhe te paraqesin qe ne kerkesen e pare te pales tjeter dhe/ose te Shoqerise te gjitha dokumentet e nevojshme ne menyre qe te kryejne te gjitha veprimet e nevojshme per regjistrimin e transferimit te ketyre Kuotave objekt te kesaj Marreveshjeje, prane Qendres Kombetare te Biznesit si dhe ne çdo autoritet tjeter sipas percaktimeve te Ligjit Shqiptar.


Kjo Marreveshje u hartua ne 2 (dy) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, me vlere te barabarte ligjore.

Marreveshja bazohet ne nenin 705 te Kodit Civil (Shqiptar) dhe ne Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

Marreveshja u lexua nga palet, u gjend e rregullt, ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe u nenshkrua rregullisht prej tyre.

SHITESI

Renato Yzo



BLERESI

Erjon Curraj

